REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 8 korrik 2013
Nr.ref.:RK449/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI44/13

Parashtruesi

Latif Latifaj

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, Rev.nr.19/2010, të 21 janarit 2013

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është dorëzuar nga Latif Latifaj, përfaqësuar nga Halil Ilazi, avokat (parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i sfiduar

2. Parashtruesi e konteston Aktgjykimin e Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev.nr.19/2010, të 21 janarit 2013, i cili i është dorëzuar më 5 shkurt 2013.

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi pretendon se Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev. nr. 19/2010, i datës 21 janar 2013 (si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.50/2009 dhe aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.244/2007 i datës 10 nëntor 2008), është i njëanshëm, i padrejtë dhe arbitrar për shkak të shkeljes së nenit 31.1 dhe 2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenit 46.3 (Mbrojtja e Pronësisë), nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave), nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Kushtetuta), si dhe nenit 6 paragrafi 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore dhe pikës 1 të Protokollit I të kësaj konvente (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 22 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejmë: Ligji) dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejmë: Rregullorja).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 29 mars 2013, parashtruesi i kërkesës parashtron kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejmë: Gjykata).

6. Më 16 prill 2013, Kryetari caktoi gjyqtarin Altay Suroy si Gjyqtar Raportues dhe Kolegjin Shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (gjyqtare kryesuese), Ivan Čukalović dhe Enver Hasani.

7. Më 10 maj 2013, Gjykatai informoi parashtruesit dhe Gjykatën Supreme për regjistrimin e kërkesës.

8. Më 25 qershor 2013, Kolegji Shqyrtues e shqyrtoi raportin e Gjyqtarit Raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

9. Më 25 tetor 2003, parashtruesi ngriti padi në Gjykatën Komunale në Gjilan për vërtetimin e pronësisë së paluajtshme dhe anulimin e kontratës për shitblerje të pronës së paluajtshme ndërmjet të paditurve, H. I. dhe Q. A., e lidhur në vitin 2002.

10. Më 17 mars 2004, Gjykata Komunale në Gjilan (C.nr.560/03) me aktgjykim vërtetoi se kontrata e lidhur ndërmjet Q. A. dhe H. I. është *"NULE"* dhe si të tillë

"pa efekt juridik". Në të njëjtën kohë ky vendim kishte obliguar të paditurin Q. A. që "t'ia dorëzojë në posedim" ngastrën kadastrale në kontest. Në bazë të këtij aktgjykimi, parashtruesi e kishte përkthyer në emrin e tij ngastrën kontestuese. Gjykata Komunale në Gjilan e vendosi lëndën në mungesë të të paditurve, të cilët ishin ftuar rregullisht për shqyrtim, ndërsa mungesën e tyre nuk e kishin justifikuar. Ky aktgjykim është bërë vendim i formës së prerë më 21 maj 2004 dhe i ekzekutueshëm më 7 korrik 2004.

11. Më 18 tetor 2005, Q. A. kishte paraqitur kërkesëpadi në Gjykatën Komunale në Gjilan kundër parashtruesit për vërtetimin e pronësisë së pronës të kontestuar në bazë të shitblerjes së vitit 1986 dhe parashkrimit fitues.

12. Në përgjigjen e dhënë në këtë kërkesëpadi, parashtruesi kishte kërkuar që kjo çështje të konsiderohet si e gjykuar (*res judicata*) me Aktgjykim të formës së prerë sipas nenit 333 paragrafi 2 të Ligjit për procedurën kontestimore të të njëjtës gjykatë me nr. C.nr.560/03. Po ashtu, ai kishte kundërshtuar bazën juridike të fitimit të pronësisë sipas parashkrimit fitues, në të cilin rast nuk është përmbushur afati kohor, ku kërkohen 20 vjet dhe faktin se sendi nuk është mbajtur me mirëbesim pasi që të paditurit nuk ia kanë mundësuar bartjen e paluajtshmërisë.

13. Më 21 nëntor 2006, Gjykata Komunale në Gjilan (Aktgjykimi C.nr.515/2005) kishte aprovuar kërkesëpadinë duke vërtetuar se paditësi *"në bazë të shitblerjes në vitin 1986 dhe në bazë të parashkrimit fitues është pronar i ngastrës"* në kontest. Gjykata, gjithashtu, obligon *"të paditurit që këtë të drejtë t'ia njohin paditësit dhe të përmbahen e të durojnë që paditësi këtë paluajtshmëri në bazë të këtij aktgjykimi ta regjistrojë në emër të tij"*. Gjykata Komunale në Gjilan konstatoi se Q. A. e kishte blerë pronën e kontestuar më 30 tetor 1986 *"në bazë të kontratës gojore respektivisht në dorëshkrim"* nga nëna e parashtruesit dhe se paratë për pagesën e ngastrës i kishte paguar në lartësi prej 15,000.00 frangash zvicerane, sipas marrëveshjes dhe menjëherë është futur në posedim faktik dhe shfrytëzim të cilin që prej atëherë e deri pas vitit 2000 e kishte poseduar dhe shfrytëzuar pa ndonjë pengesë. Gjykata Komunale në Gjilan gjithashtu konstatoi se në vitin 2002, Q. A., si posedues faktik dhe me qëllim të bartjes së pronësisë, kishte lidhur kontratë për shitblerje e vërtetuar në Gjykatën Komunale të Gjilan më 19 korrik 2002, me nr. Vr.nr.1774/2002 të ngastrës kontestuese me H. I. pasi që kjo ngastër figuronte në emrin e saj. Gjykata Komunale në Gjilan lidhur me pretendimin e parashtruesit se çështja është e gjykuar vendosi se kjo nuk është çështje e gjykuar për shkak se objekti i çështjes dhe të paditurit në kërkesëpadi janë të ndryshme nga rasti i cekur.

14. Më 23 dhjetor 2006, parashtruesi bën ankesë në Gjykatën e Qarkut në Gjilan kundër aktgjykimit të Gjykatës Komunale, të 21 nëntorit 2006, për shkak të shkeljeve esenciale të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe aplikimin e gabuar të së drejtës materiale duke propozuar që i njëjti aktgjykim të ndryshohet apo të prishet.

15. Më 14 mars 2007, Gjykata e Qarkut (Aktvendimi Ac.nr.33/2007) e prish Aktgjykimin e Gjykatës Komunale C.nr.515/2005 duke kthyer për rivendosje me arsyetimin se aktgjykimi ka *"shkelje esenciale nga neni 354 al. 2 pika 13 e LPK-*

së" dhe vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike. Gjykata e Qarkut duke vendosur në këtë ankesë, nuk kishte konsideruar se çështja duhet të konsiderohet si e gjykuar.

16. Më 10 nëntor 2008, Gjykata Komunale në Gjilan Aktgjykimi C.nr.244/2007) aprovon edhe një herë kërkesëpadinë e paditësit Q. A. kundër parashtruesit. Gjykata konstaton se paditësi "e ka fituar të drejtën e pronësisë sipas shitblerjes (të vitit 1986) pasi që ndërmjet palëve janë përmbushur obligimet e ndërsjella sipas kontratës në dorëshkrim për shitblerjen e paluajtshmërisë dhe kjo kontratë konform nenit 73 të Ligjit mbi detyrimet, është fuqiplote", por jo sipas parashkrimit. Në të njëjtën kohë, Gjykata konsideron që *"kjo çështje kontestuese nuk mund të trajtohet si çështje e gjykuar sipas nenit 333 par. 2 të LPK-së për arsye se derisa në çështjen juridike të gjykuar sipas aktgjykimit të plotfuqishëm, palë në procedurë ka qenë i padituri si paditës dhe tani paditësi H. I. si të paditur dhe baza juridike ka qenë anulimi i kontratës, ndërsa në këtë çështje juridike, përveç paditësit dhe të padituri, i kemi edhe dy të paditur të tjerë, të cilët fare nuk janë përfshirë në procedurën e mëhershme, e pastaj në këtë çështje kontestuese bëhet fjalë për bazën juridike të vërtetimit të pronësisë në bazë të shitblerjes dhe parashkrimit fitues".*

17. Më 27 dhjetor 2008, parashtruesi paraqet ankesë kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.244/2007, për shkak të 1) shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore; 2) vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike; 3) zbatimit të gabuar të së drejtës materiale. *Inter alia*, parashtruesi në ankesën e tij konsideron që kjo çështje duhet të trajtohet si e gjykuar se Q. A. nuk e ka poseduar ngastrën në afatin prej 20 vitesh me mirëbesim dhe se në rastin konkret nuk është plotësuar *"as baza juridike (iustus titullus) dhe as mënyra e fitimit (modus aquiredi) e pronësisë, të cilat kushte duhet të plotësohen kumulativisht që Q. A. të fitonte pronësinë mbi ngastrën kontestuese".*

18. Më 28 shtator 2009, Gjykata e Qarkut në Gjilan (Aktgjykimi Ac.nr.50/2009) e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit, duke vërtetuar kështu Aktgjykimin e Gjykatës Komunale C.nr.244/07 pa pasur nevojë që të përsëriten argumentet e këtij aktgjykimi pasi që gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë dhe në bazë të asaj edhe është vërtetuar se paditësi është pronar në bazë të shitblerjes të paluajtshmërisë kontestuese. Kundër këtij aktgjykimi, parashtruesi paraqet revizion në Gjykatën Supreme të Kosovës.

19. Më 21 janar 2013, Gjykata Supreme e Kosovës (Aktgjykimi Rev.nr.19/2010) e refuzon si të pabazuar revizionin e parashtruesit kundër Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.50/2009. Gjykata Supreme gjen se *"gjykata e shkallës së dytë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt i ka zbatuar dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadia e paditësit është bazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë përmban arsye të mjaftuara për faktet relevante për gjykim të drejtë të kësaj çështjeje juridike". Inter alia*, gjykata konstaton se nuk kemi të bëjmë me çështje të gjykuar dhe se nuk ka pasur zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe se paditësi pa dyshimi është pronar i paluajtshmërisë

kontestuese në bazë të kontratës të lidhur në dorëshkrim në vitin 1986 dhe e cila është përmbushur në tërësi.

Pretendimet e parashtruesit

20. Parashtruesi pretendon se aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës Rev.nr. 19/2010 të 21 janar 2013 si dhe Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut në Gjilan Ac.nr.50/2009 të 28 shtator 2009 dhe Aktgjykimi i Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.244/2007 të 10 tetor 2008 janë të njëanshëm, të padrejtë dhe arbitrarë.

21. Parashtruesi pretendon se kontesti në lidhje me ngastrën kontestuese është gjykuar njëherë me vendim të formës së prerë të Gjykatës Komunale në Gjilan C.nr.560/03 të 17 mars 2004 duke bërë NULE kontratën ndërmjet Q. A. dhe H. I. si dhe duke kërkuar dorëzimin e ngastrës kadastrale të kontestuar, e cila ngastër i ishte dorëzuar parashtruesit në procedurë përmbarimore.

22. Parashtruesi pretendon se Gjykata Supreme e Kosovës me Aktgjykimin Rev.nr.19/2010 të 21 janarit 2013 si dhe Gjykata e Qarkut me Aktgjykimin Ac.nr.50/2009 në mënyrë të njëanshme dhe arbitrare kanë pranuar aktgjykimin dhe argumentet të cilat janë konstatuar në Aktgjykimin e Gjykatës Komunale C.nr.244/2007.

23. Parashtruesi pretendon se në këtë rast atij i janë mohuar të drejtat e tij të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe konkretisht sipas nenit 31.1 dhe 2 (E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm), nenit 46.3 (Mbrojta e Pronësisë), nenit 54 (Mbrojtja Gjyqësore e të Drejtave), nenit 22 (Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve) si dhe neni 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe neni 1 paragrafi 1 i Protokollit I të kësaj konvente.

Pranueshmëria e kërkesës

24. Gjykata vëren se për të qenë në gjendje të shqyrtojë kërkesën e parashtruesit, Gjykataduhet, së pari, të vlerësojë nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore.

25. Neni 113.1 i Kushtetutës e përcakton kornizën e përgjithshme të kërkesave ligjore, në mënyrë që kërkesa të jetë e pranueshme. Ai parasheh:

> *"1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para Gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar."*

26. Neni 48 i Ligjit gjithashtu përcakton se:

> *"Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësojë saktësisht se cilat të drejta dhe liri i pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik, të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestojë."*

27. Për më tepër, rregulli 36 (2) i Rregullore parasheh se

"Gjykata do të refuzojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:
[...], ose
(b) b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese; ose
[...],
(d) kur parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij".

28. Gjykata tërheq vërejtjen se nuk është detyrë e saj të veprojë si gjykatë e instancës së katërt, në lidhje me vendimet e nxjerra nga gjykatat e rregullta. Është detyrë e gjykatave të rregullta t'i interpretojnë dhe t'i zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe materiale (Shih, Avdyli v. Gjykata Supreme e Kosovës, KI 13/09, 18 qershor 2010; Shih, *mutatis mutandis,* García Ruiz kundër Spanjës [GC], nr. 30544/96, para. 28, Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I).

29. Gjykata vetëm mund të shqyrtojë nëse provat janë paraqitur në mënyrë të drejtë dhe nëse procedurat në përgjithësi, të shikuara në tërësinë e tyre, janë mbajtur në mënyrë të tillë sa që parashtruesi të ketë pasur gjykim të drejtë (Shih, ndër autoritete të tjera, Raporti i Komisionit Evropian për të Drejtat e Njeriut në rastin Eduards kundër Mbretërisë së Bashkuar, kërkesa nr. 13071/87, e miratuar më 10 korrik 1991).

30. Në rastin e tanishëm, parashtruesit i janë paraqitur mundësi të shumta për ta paraqitur rastin e tij dhe për ta kontestuar interpretimin e dispozitave të ligjeve përkatëse, të cilat ai i konsideron si të gabuara në Gjykatën Komunale dhe të vërtetuara në Gjykatën e Qarkut dhe në Gjykatën Supreme gjatë procesit të apelit. Pas shqyrtimit të procedurës në tërësi, Gjykatanuk ka gjetur se proceduarat e duhura në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta, të njëanshme apo arbitrare. (Shih, *mutatis mutandis*, Shub kundër Lituanisë, Vendimi i GJEDNJ-së në lidhje me pranueshmërinë e kërkesës nr. 17064/06 të 30 qershorit 2009).

31. Gjykata vëren se parashtruesi ka ngritur çështjen e *res judicata* pra të çështjes së gjykuar gjatë shqyrtimit të këtij rasti në nivel komunal, por edhe gjatë procedurës së apelit në të gjitha instancat. Të gjitha instancat kanë vërtetuar se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një çështje të tillë.

32. Po ashtu, Gjykata konsideron se nuk ka asgjë në kërkesë që tregon se rastit i ka munguar paanshmëria apo që procedurat në ndonjë mënyrë kanë qenë të padrejta, të cilat do të mund të konsideroheshin si cenim i të drejtave të garantuara me Kushtetutë apo Konventën Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut dhe Protokollet e saj, të cilat janë të aplikueshme në mënyrë të drejtpërdrejtë në Kosovë. Fakti i thjeshtë se parashtruesi nuk është i kënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të pranueshme për shkelje të neneve të pretenduara të Kushtetutës përkatësisht nenit 31.1 dhe 2; neni 46.3; neni 54; neni 22 si dhe të nenit 6.1; nenit 1.1 të protokollit 1 të KEDNJ-së (Shih, Memetoviq kundër Gjykatës Supreme të Kosovës KI 50/10, 21 mars 2011; Shih,

mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005).

33. Prandaj, Gjykata Kushtetuese konstaton se pretendimet e parashtruesit të kërkesës janë qartazi të pabazuara në pajtim me nenin 48 të Ligjit dhe rregullit 36 (2) të Rregullores.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 48 të Ligjit, rregullit 36 (2) dhe rregullit 56 (2) të Rregullores, më 8 korrik 2013, njëzëri

VENDOSI

I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;

II. T'UA KOMUNIKOJË vendimin palëve;

III. TA PUBLIKOJË vendimin në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe,

IV. TË SHPALLË se ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Altay Suroy Prof. dr. Enver Hasani